

Në bazë të nenit 49 paragrafi 9 të Ligjit për duhan, prodhime nga duhani dhe prodhime të ngjashme (*) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 98/19 dhe 27/20), Ministri i Ekonomisë në marrëveshje me Ministrinë Shoqërisë Informatike dhe Administratës sjell

RREGULLORE PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E KËRKESËS PËR REGJISTRIM NË REGJISTRIN E PRODHUESVE TË PRODHIMEVE NGA DUHANI DHE PRODHIME TË NGJASHME, DËSHMITË DHE DOKUMENTACIONIN E NEVOJSHËM PËR KUSHTET MË TË AFËRTA PËR PRODHIMIN E PRODHIMEVE NGA DUHANI DHE PRODHIMEVE TË NGJASHME

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen forma dhe përmbajtja e kërkesës për regjistrim në regjistrin e prodhuesve të prodhimeve nga duhani dhe prodhime të ngjashme, dëshmitë dhe dokumentacionin e nevojshëm për kushtet më të afërta për prodhimin e prodhimeve nga duhani dhe prodhimeve të ngjashme.

Neni 2

Kërkesa për regjistrim në regjistrin e prodhuesve të prodhimeve nga duhani dhe prodhime të ngjashme dorëzohet në një formular në format A-4, në letër të bardhë.

Forma dhe përmbajtja e kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni jepen në shtojcë, e cila është pjesë përbërëse e këtij rregulloreje.

Neni 3

Së bashku me kërkesën nga neni 2 i kësaj rregulloreje duhet të bashkëngjiten dëshmitë dhe dokumentet e mëposhtme:

- Statusi aktual nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut me veprimtari prioritare prodhimi i prodhimeve nga duhani;

- Procesverbal nga Inspektorati Shtetëror i Tregut për plotësimin e kushteve të nenit 49 paragrafi 2 alenija 1, 2 dhe 3 të Ligjit për duhanin, prodhimeve nga duhani dhe prodhime të ngjashme(*);

- Formulari M1/M2 për punonjësit me të paktën dy persona me arsim të lartë në prodhim dhe kontroll të cilësisë dhe dy persona me arsim të mesëm, ose kontratë të lidhur për prodhimin nga prodhimet e duhanit me një person tjetër juridik që është i regjistruar në regjistrin e prodhuesve të prodhimeve nga duhani dhe prodhime të ngjashme.

- Diplomë për arsim të lartë të përfunduar (inxhinier bujqësor) dhe Diplomë për arsim të lartë të kryer (inxhinier teknolog);

- Aktvendim i bazuar në raport të miratuar për mbrojtjen e mjedisit për veprimtarinë/aktivitetin e prodhimit të prodhimeve të duhanit në përputhje me rregulloret në fushën e mjedisit jetësor;

- Fletëpagesë origjinale për taksën e paguar administrative në vlerë prej 250 denarë, dhe

- Fletëpagesë origjinale për taksën e paguar administrative në vlerë prej 50 denarë.

II. Kushtet për prodhimin e cigareve, duhanit vetë-rrokullisur, duhanit për llullë, duhanit për llullë uji (nargjile) dhe duhanit jo të djegshëm

Neni 4

Hapësirapër prodhimin e cigareve, duhanit vetë-rrokullisur, duhanit për llullë, duhanit për llullë uji (nargjile) dhe duhanit jo të djegshëm është një njësi e vetme teknologjike që duhet të përmbajë:

1. magazinë për lëndë të parë duhan i përpunuar;

2. magazinë përripromaterialet;

3. njësi për përgatitjen e duhanit;
4. njësi për prodhimin dhe paketimin e prodhimit të duhanit;
5. magazinë për prodhime të gatshme;
6. laborator për analiza dhe kontroll të cilësisë;
7. impiant energjetik;
8. nyjet sanitare dhe dush kabina;
9. hapësira ndihmëse për pushim dhe ushqim.

Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni:

- hapësira e prodhimit të duhanit për cigare vetë-rrokullisur, duhanit për llullë, duhanit për llullë uji (nargjile), në vend të njësisë për prodhimin dhe paketimin e cigareve, të ketë një njësi për dozimin dhe paketimin e tyre të përshtatshëm në paketim letre, kartoni, kallaji ose polietileni në varësi të ambalazhit në të cilin prodhimi është lëshuar në treg dhe

- Fabrikat e prodhimit të cigareve nuk kanë nevojë të kenë linjë teknologjike për përpunimin e duhanit, nëse duhani për prodhimin e cigareve përpunohet dhe përgatitet diku tjetër dhe si i tillë bartet në njësi paketimi, kuti dhe/ose qese polietileni dhe si i tillë shërben për prodhimin e cigareve.

Neni 5

Magazina e duhanit të përpunuar duhet të jetë e destinuar për ruajtjen e duhanit të përpunuar në sasi të mjaftueshme për një proces të qetë prodhimi njëjavor.

Repromaterialet nuk duhet të ruhen në magazinë për duhan të përpunuar.

Magazina duhet të jetë e ndërtuar nga materiali solid në përputhje me rregulloret për planifikimin dhe ndërtimin e objekteve.

Magazina duhet të ketë një ose më shumë hyrje për hyrje të papenguar, si dhe një hapësirë manipuluese për shkarkimin dhe ngarkimin e duhanit dhe pajisje për marrjen dhe klasifikimin e duhanit sipas llojeve dhe klasave të duhanit, respektivisht ruajtjen e rregullt të tij.

Magazina duhet të ketë ujë higjenikisht korrekt, ndriçim dhe ajrim natyral ose artificial.

Neni 6

Magazina e ripromaterialeve duhet të jetë e destinuar për ruajtjen e ripromaterialeve (lloje të ndryshme letre, ngjitës, aditivë, shkopiinj filtri etj.) në sasi të mjaftueshme për një proces të qetë prodhimi njëjavor.

Neni 7

Njësia për përgatitjen e duhanit duhet të përbëhet nga:

- a) hapësira për përgatitjen e përzierjes së duhanit
- b) linjë teknologjike për përgatitjen e përzierjes së duhanit
- c) magazina e duhanit të prerë;
- d) njësia për përgatitjen e salcave dhe aromave.

Hapësira për përgatitjen e përzierjes (manuali - ruajtja e përditshme e duhanit të përpunuar) duhet të sigurojë prodhimin njëditor, të shërbejë për stivimin dhe kontrollin paraprak të duhanit përpara se të dërgohet për përpunim.

Hapësira e linjës teknologjike për përgatitjen e duhanit dhe ruajtjen e duhanit të prerë duhet të jetë me ajër të kondicionuar ose të ajrosur termikisht.

Njësia e përgatitjes së duhanit të padjegshëm, përveç kërkesës së paragrafit 1, pika a) të këtij neni, duhet të ketë edhe linjë teknologjike për marrjen e duhanit të rindërtuar që përdoret për prodhimin e produktit.

Neni 8

Fabrikat për prodhimin e cigareve, duhanit vetë-rrokullisur dhe duhanit të mbështjellë duhet të kenë një linjë teknologjike për përgatitjen e duhanit që përbëhet nga:

- a) linja e lagështimit të duhanit (oda me vakum ose kondicionerë të rrjedhës);
- b) linjë për ndarjen e brinjës së duhanit nga gjethet;
- c) linja e përpunimit të brinjëve të duhanit;
- d) linja e përpunimit të duhanit Oriental dhe Virginia;

e) linja e përpunimit berlej.

Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, fabrika për prodhimin e cigareve nuk ka nevojë të ketë:

- linjë teknologjike për berlaj, nëse fabrika nuk përdor llojin berlaj në markat e produkteve të saj;
- linja teknologjike për ndarjen e brinjës së duhanit nga gjethet dhe linjën teknologjike për përpunimin e brinjës së duhanit, nëse fabrika blen brinjë të duhanit të përpunuar;
- linjë teknologjike për ndarjen e brinjës së duhanit nga gjethet nëse fabrika siguron brinjën e ndarë të duhanit nga gjethja dhe ka linjë për përpunimin teknologjik të brinjës.

-linjë teknologjike për përgatitjen e duhanit sipas kapacitetit duhet të sigurojë të paktën nevojat ditore të linjave të instaluara në njësinë për prodhimin dhe paketimin e cigareve, duhanin për cigare vetë-rrokullisur dhe duhanin për llulla.

Fabrikat për prodhimin e duhanit të padjegshëm, në vend të linjave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të kenë linjë për prodhimin e duhanit të rikonstituar ose të homogjenizuar.

Neni 9

Linja teknologjike për përgatitjen e duhanit të destinuar për prodhimin e cigareve, duhanit për cigare vetë-rrokullisur dhe duhanit për llullë duhet të përbëhet nga:

- pajisje për dozimin e vazhdueshëm dhe të kontrolluar të duhanit në procesin e prodhimit;
- pajisje për kondicionimin e duhanit me pajisje për të kontrolluar dhe rregulluar lagështinë dhe temperaturën e duhanit në dalje të pajisjeve;
- pajisje për shtimin e aditivëve me pajisje dozimi dhe kontrollin e dozimit me aditivë (salca, aromatizues, hidratues, etj.);
- të paktën një silo/harmanerkë për përzierje para prerjes së duhanit;
- pajisje për ndarjen e objekteve metalike;
- makinë për prerjen e duhanit;
- pajisje për tharjen (kondicionimin) e duhanit me dozim të kontrolluar të vazhdueshëm të duhanit dhe me pajisje për rregullimin dhe kontrollin e lagështisë së duhanit pas tharjes;
- pajisje me pajisje për dozimin dhe kontrollin e dozimit me aditivë, brinjë të zgjeruara të duhanit dhe duhan nga cigaret e ricikluara;
- pajisje për mbushjen e duhanit në kabanone duhani të prera.

Linja bazë teknologjike për përgatitjen e duhanit për llullë uji (nargjile) duhet të përbëhet nga:

- pajisje për shtim dhe gjethe të vazhdueshme të duhanit;
- pajisje për kondicionimin e duhanit me pajisje për kontrollin dhe rregullimin e lagështirës;
- pajisje për vjetërimin dhe dozimin e duhanit të kondicionuar;
- makinë prerëse duhani me rregullim të prerjes;
- kazanë për përzierjen e duhanit të prerë me shurup sheqeri ose melasë;
- pajisje për shtimin e salcave dhe aromave;
- pajisje për mbledhjen e përzierjes;
- pajisje për derdhjen në kallëpe dhe tharje të produktit të përfunduar.

Linja teknologjike për prodhimin e duhanit të rindërtuar, e destinuar për prodhimin e duhanit jo të djegshëm duhet të përbëhet nga:

- mullinj për bluarjen e lëndës së parë të duhanit;
- ciklone ose kuti për vendosjen e duhanit të bluar;
- kazanë për përzierjen e duhanit të bluar;
- pajisje për shtimin e ngjitësve, tretësve dhe aditivëve;
- shirita për shpërndarjen e folisë së lëngshme me rula për rregullimin e trashësisë;
- odat e tharjes.

Neni 10

Linja teknologjike për përpunimin e brinjëve të duhanit nëse fabrika përpunon në mënyrë të pavarur brinjët e duhanit duhet të përbëhen nga:

- hapësira për përgatitjen e brinjës së duhanit;

- pajisja për dozimin e vazhdueshëm të brinjës së duhanit në procesin e prodhimit;
- pajisja për njomjen e brinjës së duhanit;
- silos për përzierjen dhe vjetërimin e brinjës së duhanit;
- pajisja për rrotullimin e brinjës së duhanit;
- pajisja për ndarjen e objekteve metalike;
- makina për prerjen e brinjëve të duhanit;
- pajisja për zgjerimin e brinjës së duhanit të prerë me një pajisje për dozimin e vazhdueshëm të kontrolluar;
- pajisja për tharjen e brinjës së zgjeruar të duhanit me pajisje për kontrollin dhe rregullimin e lagështirës së daljes;
- pajisja për ndarjen e brinjëve të duhanit të paprerë dhe të pazgjeruar;
- silos për ruajtjen e brinjës së duhanit deri në momentin e shtimit në përzierjen bazë.

Neni 11

Linja teknologjike për përpunimin e duhanit berlej, nëse fabrika përdor këtë lloj duhani, duhet të përbëhet nga:

- hapësira për përgatitjen e përzierjes së duhanit berlej;
- pajisja për shtimin e aditivëve me pajisje të dozimit dhe kontrolltë dozimit;
- pajisja për pjekjen dhe kondicionimin e duhanit berlej me pajisje për vendosjen dhe kontrollin e temperaturës së pjekjes dhe lagështisë së dalë të duhanit Berlej ose nga pajisjet për njomjen, ngrohjen dhe trajtimin me presion të duhanit Berlej.

Neni 12

Magazina e duhanit të prerë duhet të përbëhet nga arka prej çeliku të pandryshkshëm ose silos me kapacitet të paktën një ditë prodhimi, të destinuara për ruajtjen e duhanit të përgatitur deri në momentin e përdorimit të tij në linjën e prodhimit të cigareve.

Temperatura dhe lagështia e ajrit në magazinë e duhanit të prerë duhet të kontrollohen dhe rregullohen.

Neni 13

Njësia për përgatitjen e salcave dhe aromave duhet të jetë e pajisur me enë, mikser, përzierje dhe ngrohje, pajisje për dozimin e përbërësve dhe kontrollin e temperaturës së aditivëve.

Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni nuk zbatohen nëse fabrika e cigareve siguron salca dhe aromat tashmë të përgatitura.

Neni 14

Njësia e prodhimit dhe paketimit të cigareve, duhanit vetë-rrokullisur, duhanit llullës, duhanit për llullë uji (nargjile) duhet të jetë me ajër të kondicionuar, të pajisur me të paktën një linjë për prodhimin dhe paketimin.

Njësia për dozimin dhe ambalazhimin e duhanit për cigare vetë-rrokullisur, duhan llullë, duhan për llullë uji (nargjile) duhet të përbëhet nga një linjë për dozimin e duhanit dhe një linjë për paketimin në ambalazhe përkatëse (kupa alumini, qese plastike ose kuti plastike).

Neni 15

Linja e prodhimit të cigareve duhet të përbëhet nga:

- makina për përgatitjen e cigareve;
- makina për aplikimin e filtrit;
- makina grumbulluese cigaresh (në rastin e një linje të veçantë të prodhimit të cigareve dhe linjës së paketimit).

Linja e prodhimit të duhanit jo të djegshëm duhet të ketë të njëjtat makineri si për prodhimin e cigareve.

Neni 16

Në linjën e prodhimit të cigareve duhet të ketë kontrole në:

- masat e cigareve;
- dimensionet e cigareve;
- mbushjen e majës së cigares;

- pranisë së filtrit;
- dëmtimet e cigareve.

Neni 17

Në makinën e paketimit të duhanit për cigare vetë-rrokullisur, duhan llullë, duhan dhe llullë uji (nargjile), duhet të ketë kontroll të masës së dozuar për çdo paketë.

Neni 18

Linja e paketimit të cigareve duhet të përbëhet nga:

- pajisjet mbushëse në njësitë e paketimit (në rastin e një linje të veçantë të prodhimit të cigareve dhe linjës së paketimit);
- makina për formimin e paketimeve të vetme - kutive;
- pajisja për vendosjen e pullave të akcizës;
- makina për mbështjelljen e paketave të vetme - kuti me të paktën 20 cigare në ambalazh të fortë ose të butë, grupim paketash të vetme - kuti, në ambalazhim grupor - një kuti cigaresh me ambalazh të fortë ose të butë;
- paketimi i transportit të kutive në kuti më të mëdha mund të bëhet manualisht ose mekanikisht.

Linja e paketimit të duhanit jo të djegshëm duhet të përbëhet nga:

- pajisjet mbushëse në njësitë e paketimit (në rastin e një linje prodhimi të veçantë, dhe linjë paketimi);
- makina për formimin e paketave-kutive;
- pajisjet për vendosjen e pullave të akcizës;
- makina për mbështjelljen e paketave të vetme-kuti;
- grupimi i pakove individuale - kuti, në pako grupe - arka, kuti formimi dhe ambalazhi;
- paketimi i transportit të kutive në kuti më të mëdha bëhet në mënyrë manuale ose mekanike.

Linja e paketimit të duhanit për cigare vetë-rrokullisur, duhan llullë, duhan për llullë uji (nargjile) duhet të përbëhet nga:

- makina ambalazhimi në ambalazhe individuale të produktit me pajisje për vendosjen e pullave të akcizës;
- makina për paketimin në grup të produktit;
- paketimi i transportit të produkteve në kuti më të mëdha bëhet me dorë ose makinë.

Neni 19

Në linjën për paketimin e cigareve në pako duhet të ekzistojnë kontrole të:

- pranisë së të gjitha cigareve në paketimin;
- mbushja e duhanit në maje të cigareve (skuqje e duhanit të prerë);
- prani e filtrit;
- prani e mbështjellësit të brendshëm (alufoli etj.);
- prani e mbështjellësit të jashtëm;
- prani e markës së akcizës;
- prani e fijos për hapjen e paketimit;
- prani e filmit mbështjellës në paketimin;
- prani e mbështjellësit të shtekës;
- prani e të gjitha paketimeve në shtekën.

Në linjën e paketimit të duhanit të padjegshëm në paketim duhet të ekzistojnë kontrole të:

- pranisë së të gjitha produkteve të padjegshme të duhanit në paketimin;
- prani e filtrit;
- prani e mbështjellësit të brendshëm (alufoli ose ngjashëm);
- prani e mbështjellësit të jashtëm;
- prani e markës së akcizës;
- prani e fijos për hapjen e paketimit;
- prani e filmit mbështjellës të paketimit;
- prani e mbështjellësit të shtekës;

- prani e të gjitha paketave në shtekën.

Në linjën për paketim të duhanit për mbështjellje të pavarur të cigareve, duhanit për llullë, duhan për llullë me ujë (nargjile) duhet të ekzistojnë kontrolle të:

- pamjes dhe pranisë së mbështjellësit të jashtëm;
- prani të markës së akcizës;
- pesha e produktit.

Neni 20

Përmes stacioneve energjetike, prodhuesi i produkteve të duhanit dhe produkteve të ngjajshme, duhet të sigurojë furnizim me ujë, avull të ujit, ajr të kompresuar, në varësi prej nevojave të makinave.

Neni 21

Magazina e produkteve të gatshme duhet të jetë i dedikuar për magazinimin e sasive plotësuese të produkteve të gatshme për distribuim në kohë në treg.

Në magazinën e produkteve të gatshme ekskluzivisht duhet të magazinohen produkte të duhanit dhe të ngjajshme të dedikuara për konsum përfundimtar.

Magazina duhet të jetë e ndërtuar nga materiali i fortë në përputhje me rregullat për planifikimin dhe ndërtimin e objekteve.

Magazina duhet të ketë një ose më shumë hyrje për qasje pa pengesë, si dhe hapësirë hapësirë manipulative për shkarkim dhe ngarkim të produkteve të duhanit dhe pajisjes për marrjen dhe renditjen e produkteve të duhanit sipas llojeve dhe etiketave të produkteve të duhanit dhe produkteve të duhanit, respektivisht magazinim të rregullt të të njëjtave.

Magazina duhet të ketë ujë higjienikisht të rregullt, ndriçim natyral ose artificial dhe ajrosje.

Neni 22

Prodhuesi i produkteve të duhanit dhe produkteve të ngjajshme, duhet të disponojë me laborator për analizën e lëndës hyrëse dhe kontroll të kualitetit të produkteve.

Laboratori duhet të ketë pajisje dhe aprate për monitorimin e vetive fizike dhe kimike të lëndës hyrëse, produktit të gatshëm si dhe përbërësve kryesorë të tymit të duhanit edhe atë:

a) për monitorimin e përbërjes kimike të lëndës hyrëse të produktit të gatshëm:

- aparat për destilimin e ujit;
- furre për pjekje deri në 950 °C;
- matës pH
- aparat për destilimin e nikotinit;
- spektrofotometër me gjatësi vale të përshtatshme për përcaktimin e nikotinës;
- aparat për përcaktimin e proteinave;
- pajisje për përcaktimin e sheqernave dhe polifenoleve të tretshme;
- vegla laboratorike prej qelqi dhe porcelani (gota vegjetale, balonat erlenmajerë, shishe, gota laboratorike, hinkë, pipeta dhe bireta);

b) për monitorimin e vetive fizike të cigareve:

- tharëse (të paktën deri në 200 °C);
- vagë precize (të paktën 2 vende decimale);
- matës i fortësisë së cigareve dhe filtrit;
- matës i dimensioneve (gjatësisë, diametrit) të filtrit dhe cigareve;
- aparat për përcaktimin e rezistencës ndaj tërheqjes së filtrit dhe cigares;
- aparat për përcaktimin e ventilimit të cigareve;

c) për monitorimin e përbërësve kryesorë të tymit të cigares, gjegjësisht nikotinës, katranit dhe oksid karbonit:

- makinë për tymosjen e cigareve sipas standardeve ISO;
- pajisje për caktimin e ujit në kondensatin e papërpunuar nga tymi;
- pajisje për caktimin e oksidit të karbonit (CO) në tym;
- vagë analitike (të paktën 4 vende decimale).

Nëse prodhuesi nuk disponon pajisje dhe aparaturë për monitorimin e parametrave nga paragrafi 2 i këtij neni, ose disa prej tyre, të njëjtat duhet t'i sigurojë nga laborator vendor me marrëveshje të lidhur paraprake.

Me përjashtim të paragrafit 2 të këtij neni, prodhuesi i produkteve të ngjashme, kontejnerëve për mbushje të vetme dhe të shumëfishtë të cigareve elektronike në laboratorin e tij duhet të ketë:

- aparate për distilimin e ujit;
- furrë për pjekje deri në 950 oC;
- njehsor pH;
- aparat për distilimin e nikotinës;
- spektrofotometër me gjatësi vale të përshtatshme për përcaktimin e nikotinës;
- pajisje laboratorike prej qelqi dhe porcelani (gota vegjetale erlenmajerë, shishe, gota laboratorit, hinka, pipetat dhe biretat).

III. Kushte për prodhimin e purove dhe cigarilove

Neni 23

Për prodhimin e purove dhe cigarilove, fabrika duhet të disponojë hapësirë për përgatitjen e duhanit, hapësirë për përpunimin e produktit, hapësirë për përpunim shtesë (sortim, presim, shtrirje paketim, paketim dhe magazinim).

Prodhimi i cigarilove duhet të realizohet me makinë, kurse prodhimi i purove mund të realizohet me makinë ose me dorë.

Për operacionet e përmendura, duhet të përdoren pajisje ose makina që janë të përshtatshme për dedikimin.

IV. Kushtet për prodhimin e produkteve të ngjashme

Neni 24

Hapësira për prodhimin e lëngjeve të dedikuara për cigare elektronike duhet të ketë hapësirat vijuese:

1. magazina e kimikateve që përdoren të dedikuara për mbushjen e kontejnerëve me lëngje;
2. magazinë për materiale ripromateriale;
3. repart për përgatitjen, mbushjen dhe paketimin e kontejnerëve;
4. magazinë e produkteve të gatshme;
5. laborator për analiza dhe kontroll të cilësisë;
6. impiant energjetik;
7. lidhje sanitare dhe kabina dushi ;
8. hapësira ndihmëse për pushim dhe ushqim.

Neni 25

Magazina për kimikate duhet të jetë e dedikuar për ruajtjen e kimikateve të mëposhtme: nikotinë, glikol i propiluar, glicerinë, alkool, ekstrakte të vajrave eterikë si dhe përbërës të tjerë kimikë që përdor fabrika.

Hapësira për magazinimin e kimikateve që përdoren gjatë mbushjes së kontejnerëve me lëngje duhet të ketë kapacitetin për akomodimin e sasive të mjaftueshme për një javë prodhim të pandërprerë.

Repromaterialet nuk duhet të mbahen në magazinë.

Magazina duhet të jetë e ndërtuar me material të fortë në përputhje me rregullat për planifikimin dhe ndërtimin e objekteve dhe duhet të plotësojnë kushtet për magazinimin e sigurt të kimikateve.

Magazina duhet të ketë një ose më shumë hyrje për akses të papenguar, si dhe hapësirë manipulative për shkarkimin dhe ngarkimin e duhanit dhe pajisje për marrje dhe klasifikimin e duhanit sipas llojeve dhe klasave të duhanit, gjegjësisht, magazinimi i rregullt i të njëjtit.

Magazina duhet të ketë ujë higjienikisht të rregullt, ndriçim dhe ajrim natyral ose artificial.

Neni 26

Magazina e ripromaterialeve duhet të jetë e dedikuar për ruajtjen e ripromaterialeve (lloje të ndryshme letre, karton, polietilen, ngjitës, kontejnerë etj.) në sasi të mjaftueshme për prodhimin e pandërprerë njëjavor.

Neni 27

Reparti për përgatitjen, mbushjen dhe paketimin e kontejnerëve duhet të ketë:

- pajisje për dozimin dhe përzierjen e vazhdueshme, të kontrolluar të kimikateve në procesin e prodhimit dhe
- pajisje për mbushjen e kontejnerëve me përzierjen e përgatitur të kimikateve.

Reparti nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të jetë me ajër të kondicionuar, të pajisur së paku me një linjë për prodhim dhe paketim në ambalazhë të përshtatshme edhe atë:

- në kontejnerë specialë për mbushje të shumëfishta me vëllim jo më të madh se 10 mL,
- në kontejnerë ose në patrren një përdorim, kurse vëllimi i fishekëve ose rezervuarëve nuk duhet të kalojë 2 mL

Linja e paketimit të kontejnerëve duhet të përbëhet nga:

- makinë ambalazhimi në ambalazhe individuale të produktit me pajisje për vendosjen e pullave të akcizës;
- makinë për paketimin në grup të produktit;
- paketimi i transportit të produkteve në kuti më të mëdha bëhet me dorë ose makinë.

Në linjën e paketimit duhet të ketë kontrolle të:

- pamjes dhe pranisë së shtresës së jashtme;
- pranisë së pullës së akcizës;
- vëllimit të produktit.

Neni 28

Hapësira për prodhimin e produkteve për pirjen e duhanit nga materialet bimore (prej bimëve), duhet t'i përmbushë kushtet nga neni 4 paragrafi 1, nenet 5 dhe 6 dhe nenin 7 paragrafi 1, 2 dhe 3 të kësaj rregulloreje.

Neni 29

Linja teknologjike për përgatitjen e materialit bimor duhet të përbëhet prej:

- pajisjeve për dozimin e vazhdueshëm dhe të kontrolluar të materialit bimor në procesin e prodhimit;
- pajisjeve për kondicionim me pajisje për kontrollin dhe rregullimin e lagështisë dhe temperaturës së materialit bimor në dalje të pajisjeve;
- pajisjeve për veçimin e primesave;
- pajisjeve dhe pajisjes për dozimin dhe kontrollin e dozimit me aditivë (sose, aromatë, humekntantë, etj.);
- së paku një silos/harmanerkë për përzierje para prerjes së materialit bimor;
- pajisjeve për veçimin e sendeve metalike;
- makinës për prerje;
- pajisjeve për tharrje plotësuese (kondicionim) me dozimin e kontrolluar të vazhdueshëm dhe me pajisje për rregullimin dhe kontrollin e lagështisë së materialit bimor pas tharrjes;
- pajisjeve me aparate për dozimin dhe kontrollin e dozimit me aditivë;
- pajisjeve për mbushjen e materialit të përgatitur në silosë.

Neni 30

Linja teknologjike për përgatitjen e materialit bimor duhet të ketë magazinë për shënimin e materialit të prerë që e përbëjnë sëndukë të përpunuar nga çeliku jokoroziv ose silosë me kapacitet prej së paku një prodhimitari njëditore, të dedikuar për ruajtjen e duhanit të përgatitur deri në momentin e përdorimit të tij në linjë për përpunimin e cigareve.

Temperatura dhe lagështia e ajrit në magazinë e materialit të prerë duhet të jenë të kontrolluara dhe rregulluara.

Neni 31

Reparti për përpunimin dhe paketimin e produkteve për pirje të duhanit nga materiali bimor duhet t'i përmbushë kushtet nga nenet 14, 15 dhe 16 të kësaj rregulloreje.

Neni 32

Linja për paketim të cigareve të përpunuara nga materiali bimor duhet të përbëhet nga:

- pajisje për mbushjen e njërive të paketuara (në rast të linjës së veçuar, të veçantë për përpilimin e cigareve dhe linjës për paketim);
- makinë për formimin e paketimeve-kutive të ndara;
- makinë për mbështjelljen e paketimeve-kutive të ndara në paketim të fortë dhe të butë, grupimin e paketimeve-kutive të ndara, në paketim në grup – shtekë e cigareve me paketim të fortë ose të butë;
- paketim për transport të shtekave në kuti më të mëdha, realizohet me dorë ose me makinë.

Neni 33

Në linjën për paketim të cigareve bimore në kuti duhet të ekzistojë kontroll i:

- pranisë së të gjitha cigareve në paketimin;
- pranisë së filtrit;
- pranisë së mbështjelljes së brendisë (alufoli etj.);
- pranisë së mbështjellësit të jashtëm;
- pranisë së fijos për hapjen e paketimit;
- pranisë së mbështjellësit të paketimit;
- pranisë së mbështjellësit të shtekës;
- pranisë së të gjitha paketave në shtekën.

Neni 34

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje pushon të vlejë Rregullorja për kushtet për prodhimin e produkteve të duhanit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.31/07 dhe 85/09).

Neni 35

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Ministër i Ekonomisë
Kreshnik Bekteshi n.p.

Nr. 11-6108/2
5 nëntor të vitit 2020
Shkup

Ministër i Shoqërisë Informatike dhe Administratës
Jeton Shaqiri n.p.

Nr. 08/3-3174/5
30 tetor të vitit 2020
Shkup